



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.11/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtar të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-dega në xxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2017-082, i njëjti në procedurë te Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/06/2017, për pretendimin për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe 1.4 shkelje e Kodit të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, z. Kadri Begolli dhe gjyqtarit xxxxx xxxxx me datë 20.07.2017 merr këtë:

V E N D I M

Xxxxx xxxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxxx-Dega në xxxxx, **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, dhe 1.4 shkelje e kodeve të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), siç është pretenduar në raportin përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2017-082.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor i'a ka paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Raportin përfundimtar ZPD-2017-082 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar xxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-dega në xxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2- neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodit të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Hetimin disiplinor Zyra e Prokurorit Disiplinor e kishte iniciuar në bazë të parashtrësës së xxxx xxxxxx, e cila në parashtrësë kishte theksuar se pas dhunës sistematike nga bashkëshorti i saj rastin kishte vendosur ta paraqes në polici. Sipas ZPD-së gjyqtari xxxx xxxx mundë të ketë kryer sjellje të pahijshme duke neglizhuar funksionin gjyqësor të paraparë në nenin 34/1.2 të Ligjit për Këshillin gjyqësorë të Kosovës (LKGJK) dhe shkelje relevante të Etikës nga nenet 34/1.4 të LKGJK-së. Faktet të cilat i kishte grumbulluar ZPD-ën domosdo e kishin qar deri të vendimmarrja për përpilimin e këtij raporti për iniciimin e procedurës disiplinore, sepse duke e

ushtruar funksionin gjyqësor, gjyqtari në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për periudhën kohore prej 35 ditës, nuk i ka ofruar mbrojtjen e kërkuar gjyqësore nga pala përgjegjëse-bashkëshorti i saj Alban Veseli, duke llogaritur nga data 03 mars 2017 deri me datën 07 prill 2017, veprim ky që është në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 të ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, që e përcakton se gjykata kompetente vendos përkitazi me kërkesën për urdhër mbrojtje brenda 15 ditëve, llogaritur pas pranimit të kërkesës për urdhër mbrojtje. Parashtruesja gjatë gjithë kohës ka kërkuar lejimin e urdhrit mbrojtës gjithnjë duke potencuar rrethanat në të cilat ajo ka jetuar dhe përjetuar çaste dhune nga dhunuesi në familje pala përgjegjëse, me çka është dëmtuar imazhi i gjyqtarit dhe sistemi gjyqësor në përgjithësi.

Gjyqtari xxxx xxxxx në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor deklaroi se pala e mbrojtur për herë të parë ka paraqitur kërkesën për mbrojtje nga dhuna me datë 25.01.2017. Me datë 15.02.2017 pala e mbrojtur Besa Gashi e cila konsiderohet që ka qenë e ekspozuar nga dhuna nga bashkëshorti i saj Alban Veseli ka tërhequr propozimin e saj në tërësi, gjegjësisht kërkesën e saj për mbrojtje nga dhuna. Rasti i parë ka qenë i evidentuar me numër të lëndës C.nr 32/17 ku gjyqtari i cili ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë Isa Gashi, me aktvendim më shkrim me datës 20.02.2017 ka konstatuar se pala mbrojtur Besa Gashi nga fsh Orllat ndaj palës përgjegjëse xxxx xxxxx nga fsh Magure, e ka tërhequr kërkesën për caktimin e mbrojtjes nga dhuna në familje.

Pas kësaj faze pala e mbrojtur me datë 21.02.2017, ka parashtruar kërkesës të re në të njëjtin gjykatë duke e kërkuar urdhër mbrojtjes emergjent. Me datë 22.02.2017, sipas radhës ngarkohem unë me atë lëndë si gjyqtar i çështjes. Në momentin e marrjes së kërkesës edhe pse kam pas ngarkesës lëndësh të nesërmen në ora 14:00 e kam caktuar seancën duke i ftuar palët, si dhe duke njoftuar zyrën për ndihmën për mbrojtjen e viktimave. Me datë 23.02.2017 në orën 14:00 kanë marrë pjesë si: pala mbrojtur, pala përgjegjëse edhe mbrojtësi i viktimave xxx xxxx. Gjatë shqyrtimit përveç kërkesave që kanë ekzistuar në kërkesën për urdhër mbrojtës, pala mbrojtur ka parashtruar edhe një kërkesë të re, kërkesa përkatësisht edhe tri kërkesa. E para ka qenë caktimi i kujdestarisë së përkohshme të fëmijës meqenëse palët kanë pasur një fëmija 3 vjeçar. Kërkesa e dytë ka qenë kërkesa për pagimin e qirasë, ndërsa kërkesa e tretë ka qenë për caktimin e alimentacionit. Në këtë fazë të procedurës bazuar në kërkesat e palës mbrojtur, duke u bazuar në ligjin e familjes, kam qenë i detyruar të kërkoj mendimin e qendrës për punë sociale, e cila ka pas për detyrë që të jap mendimin e saj lidhur me atë se kujt mund të besohet femja, gjata fazës deri sa ka qenë duke u zhvilluar procedura si dhe eventualisht nëse vendoset për urdhër mbrojtës për fazën sa vlen urdhri mbrojtës. Meqenëse janë paraqit kërkesa të reja unë kam shtyrë seancën për një javë deri me datë 03.03.2017. Të njëjtën ditë kam kërkuar nga qendra për punë sociale dhe të nesërmen qendra me ka njoftuar se e ka pranuar kërkesën tonë për dhënien e mendimit për besimin e fëmijës.

Ne seancën e parë të datës 23.02.2017 kam marr vendim dhe e kam aprovuar kërkesën për urdhër mbrojtës emergjent, duke aprovuar palës mbrojtur të gjitha pikat, gjegjësisht masat me të cilat pala mbrojtëse ka qenë e siguruar dhe mbrojtur nga pala përgjegjëse.

Është aktvendimi që është në fund të procesverbalit të datës 23.02.2017 dmth dita kur është mbajtur seanca e parë, duke u bazuar në dispozita ligjore që është obligim që brenda 24 orëve të caktohet urdhri mbrojtës emergjent, theksoj që si gjyqtar i çështjes i ka aprovuar të gjitha pikat ose gjitha masat që kanë të bëjnë me sigurimin e palës mbrojtur nga pala përgjegjëse, përveç pjesës që është bërë një kërkesë e re gjatë seancës dhe për këtë çështje e kam lënë që të merret mendimi i Qendres për Punë Sociale.

Me datë 03.03.2017, në seancën e dytë kanë marr pjesë përveç palëve në procedurë avokati xxxxx xxxxx i autorizuari i palës përgjegjëse, mbrojtësi i viktimave xxxx xxxxx si dhe përfaqësuesja e QPS se Lipjanit Fjolla Ibrahim. Gjatë kësaj seance palët kanë qëndruar pranë kërkesave të tyre, ndërsa përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale është deklaruar se në këtë seancë nuk kem mund që të japin mendimin e plot se kujt do t'a besojmë fëmijën për shkak të kompleksivitetit të situatës ndërmjet palëve. Palët kanë qenë këmbëngulëse si nëna ashtu edhe prindi, babai, që fëmijën kërkojnë që tju besohet atyre, çoftë pala përgjegjëse çoftë pala mbrojtjes.

Me datë 03.03.2017 përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale për shkak të kompleksivitetit të situatës dhe kërkesave të të dy palëve, propozimi ka qenë që të dy prindërve të ju besohet fëmija, një javë një javë tjetrit.

Në këtë seancë përfaqësuesi i palës përgjegjëse avokati Isuf Bytyqi, kur njoftohet se pala e mbrojtur ka paraqitur ankesë të ZPD-ja, propozon që sipas tij gjyqtari mundë të jetë i njëanshëm dhe ka kërkuar përjashtimin tim. Kështu që gjyqtari xxxxx është dashur që ta ndërpres dhe ta njoftoj kryetaren e gjykatës për këtë kërkesë. Te nesërm me datë 17.03.2017 gjyqtari xxxxx e kishte dërguar lëndën të kryetarja e gjykatës dhe e kishte njoftuar kryetaren për rrjedhën e procedurës.

Me datë 24.03.2017 kryetarja e Gjykatës me aktvendimin GJA.nr.354/17 e kishte refuzuar kërkesën e përfaqësuesit të palës përgjegjëse xxx xxxx për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes dhe çështja prapë ishte kthyer tek gjyqtari xxxxxi cili menjëherë kishte caktuar seancë me datë 07.04.2017. Pala e mbrojtur përmes përfaqësuesit të saj mbrojtësit të viktimave xxxx xxxxx Sadiku tërhiqet nga të gjitha kërkesat përveç një kërkesë që gjykata ta caktoj një masë që pala përgjegjëse mos ta rrezikoj. Gjyqtari ka deklaruar se ka insistuar disa here duke e pyetur se zonje a je e vetëdijshme se çfarë veprimi jeni duke e bërë dhe a po e dinë se pse po tërheqësh. Pala e mbrojtur

ishite përgjigjur se ishte pajtuar me bashkëshortin, tani kanë raporte te mira dhe nuk kanë më problem.

Ka theksuar se të njëjtën ditë e ka prurë vendimin dhe e ka aprovuar pjesën e cilën ka mbetur pran saj ndërsa e kishte refuzuar gjegjësisht e kishte konsideruar si të tërhequr për të gjitha kërkesat tjera për të cilat ishte tërhequr pala e mbrojtur. Interesin me të madh gjyqtari xxxxxx ka deklaruar se e kishte pasur që të mos dëmtohet fëmija dhe se të gjitha pengesat tjera që janë paraqitur gjatë seancave nuk janë neglizhencë e imja, kanë qenë pengesa që gjyqtari nuk i kishte bërë me qellim, këto ishin bërë për shkak të kërkesave që janë paraqitur nga pala, ka deklaruar gjyqtari xxxxxx në seancë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroi se hetimin disiplinor ZPD e ka orientuar vetëm në një kërkesë nuk i ka ofruar mbrojtjen e kërkuar gjyqësore nga pala përgjegjëse bashkëshorti i saj xxxx xxxx, plotë 35 ditë, llogaritur prej 03 mars deri me 7 prill 2017 që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga Dhuna në Familje që përcakton se gjykata duhet brenda 15 ditëve të veproj lidhur me kërkesën e palës mbrojtëse. Është fakt se kërkesa për nisjen e procedurës incizuese është bërë nga zyra për mbrojtje nga dhuna në familje, dhe kërkesat nga ajo shkresë kanë qenë disa: Kërkesa për dhënien e urdhrin për mbrojtje emergjente, kërkesa për pagimin e alimentacionet, kërkesa për mos ofrimin e palës për siguri fizike të palës së mbrojtur dhe se fundi kërkesa për kujdesin për fëmija. Vetëm në pjesën e parë që ka atë bej me detyrimin e gjykatës për të shuarjen e mbrojtjes emergjente, gjykata ka vepruar kohë dhe ka lejuar këtë urdhër për periudhën 8 ditore. Me kalimin e afatit 8 ditor pala e mbrojtur nuk ka pasur më mbrojtje gjyqësore pavarësisht që procedura me apo pa dije është orientuar në kërkesa të tjera, të cilat në esencë nuk janë qenësore- sa është qenësore mbrojta e palës së mbrojtur. Kërkon nga Komisioni disiplinor që provat e administruara në seancë të aprovoj, ta aprovoj raportin përfundimtar, dhe varësisht prej gjetjeve në seancë, të shqiptoj gjyqtarit masë disiplinore.

Gjyqtari xxxx xxxxxx në fjalën përfundimtare deklaroi se ZPD në momentin kur ka pretenduar se ka konstatuar sjelljen e pahijshme dhe neglizhencën, rastin e ka shikuar vetëm në një segment, sikur mos të kish pasur asnjë kërkesë tjetër në procedurë. Edhe sikur të mos kishte pasur kërkesa tjera, mendoj se nuk ka pasur lëshim të afatit, ligji e parasheh që nga dita e pranimit të kërkesës për 15 ditë të merret vendimi për urdhër mbrojtje. Nga momentit kur ka skaduar afati për urdhër mbrojtje emergjente, faktikisht ditën me datë 03.03.2017 kur e kam caktuar seancën për dhënien e urdhrin për mbrojtje, e ka llogaritur afatin prej 14 dite që palës të caktohet urdhri i mbrojtjes. Në këtë rast nuk kam mundur të vendos sepse i autorizuari i palës ka kërkuar përjashtimin tim dhe se unë nuk kam mundur të vendos sepse nuk ma lejon ligji dhe se në çoftë se kisha ndërmarr ndonjë veprim gjatë kësaj kohe deri sa ka vendosur kryetarja, do të kisha bërë shkelje të rëndë të

ligjit. Nuk kam mundur qe pa mendimin e Qendre për Punë Sociale të vendos se cilit prind të ja besoj fëmijën edhe në qofte se është me marrëveshje midis palëve, sepse këtu është në pyetje interesi i fëmijës dhe se këtu shkelen te drejtat e fëmijëve qe mbrohen edhe me Konventa Ndërkombëtare. Njeri nga prindërit nuk ka pasur as bukë për të hëngër sepse ka jetuar me prindërit qe i ka pasur të pensionuar. Gjyqtari xxxxx në fund ka kërkuar nga Komisionit qe të vendos sipas asaj qe është e përcaktuar me ligj.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provave në shkresat e lëndës, ka dëgjuar edhe deklarata e gjyqtarit të dhënë gjatë seancës dëgjimore, dhe pasi i ka shqyrtuar dhe analizuar konstatoj se gjyqtari xxxxx nuk është përgjegjës për sjellje të pahijshme të pretenduara në raportin përfundimtar të ZPD-së, dhe nuk ka neglizhuar në kryerjen dështim për të kryer apo abuzim të funksioneve gjyqësore, nuk ka dështuar të kryej funksionet gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe nuk ka shkelur kodin relevant të etikes për gjyqtar, me rastin e vendosjen së dhënies së urdhrorit për mbrojtje.

Gjyqtari xxxxxx ka vendosur për dhënien e urdhrorit për mbrojtje emergjente në afatin ligjor, në afat prej 8 dite dhe atë nga datës 23 shkurt deri me datën 03 mars 2017. Ligji për mbrojtje nga Dhuna në Familje parasheh afatin 15 dita nga dita e paraqitjes se kërkesës afatin për dhënien të urdhrorit për mbrojtje. Me datë 03.03.2017, gjyqtari ka llogaritur qe në afatin ligjor prej 14 dite palës ti caktohet urdhrorit për mbrojtje, prej momentit të skadimit të urdhrorit për mbrojtje emergjente, mirëpo nuk ka mundur të vendos sepse i autorizuari i palës përgjegjëse ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit xxxxx nga rasti pasi është njoftuar qe pala e mbrojtur ka paraqitur ankesë të ZPD-ja, dhe se në këtë situatë sipas tij gjyqtari mund të jetë i njëanshëm.

Gjatë kësaj kohe gjyqtari nuk ka mundur me të ndërmarr asnjë veprim deri sa ka vendosur kryetarja për kërkesën për përjashtim. Kryetarja e Gjykatës kishte vendosur me aktvendim GJA.nr.354/17 datë 24.03.2017 dhe ja kishte refuzuar kërkesën për përjashtim përfaqësuesit të palës përgjegjëse dhe çështja i është kthyer prapë gjyqtarit të i cili ka qenë duke e zhvilluar procedurën, në këtë rast gjyqtarit xxxxx. Me datë 07.04.2017 gjyqtari kishte caktuar seancën e radhës në të cilën seancë pala e mbrojtur përmes përfaqësuesit të saj mbrojtësit të viktimave, tërhiqet nga të gjitha nga të gjitha kërkesat përveç kërkesës qe gjykata të caktoj një masë që pala përgjegjëse të mos rrezikoj, duke u deklarua në seancë se i kanë rregulluar raportet me bashkëshortin dhe se më nuk ka probleme me të. Komisioni konstatoj se nuk ka mandat qe te lëshohet në përmbajtjen e vendimit.

Në rrethana të lartpërmendura, Komisioni konstaton se gjyqtari xxxxx nuk ka kurrfarë përgjegjësie disiplinore sa i përket kësaj çështje penale sa i përket afatit për dhënien e urdhrorit për

mbrojtje, për shkak se gjatë zhvillimit të procedurës janë parashtruar kërkesa te reja nga palët për të cilat gjyqtari është dashur te vendos.

Duke patuar parasysh të gjitha këto, Komisioni vlerëson se në këtë rast gjyqtari xxxx xxxx nuk ka kryer sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD dhe nuk është involvuar me ndonjë veprim konkret qe do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër theksuara, Komisioni ka konstatuar se gjyqtari xxxxx xxxxxx **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të parapara me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.2, dhe 1.4 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nuk ka shkelur standardet e Kodit e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar. Në seancën për këshillim dhe votim, njëzëri vendosi qe xxx xxxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxxx-Dega në xxxxxx të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, prandaj vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.11/2017, datë 20.07.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Gjyqtari, Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimi të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxx xxxxx, kryetare në Gjykatën Themelore në xxxxx;
- Xxxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx-Dega në xxxxxx;
- Departamenti të Administratës dhe Personelit në SKGJK;

